



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 153 Prot.

Tiranë, më datë 31.05.2024

**VENDIM**  
**Nr. 131, datë 31.05.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 31.05.2024:

**VENDOSI:**

- Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” dhe parkim nëntokësor”, në qytetin e Beratit, me aplikues Znj. Meleqe Spahiu dhe zhvillues **Bashkia Berat, me argumentin:**
  - Depozitim të një propozimi të ri arkitektonik, i cili nuk duhet të ketë kontraste me traditën ndërtimore lokale, sipas Nenit 7, të VKM nr. 827, datë 28.12.2023;
  - Zhvilluesi të depozitojë një konfirmim nga institucioni përgjegjës në fushën e arsimit lidhur me përzierjen e funksioneve, të propozuara në projekt;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.  
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Sokol ISMAILI**



**KRYETAR**  
**Blendi GONXHJA**